

ANALIZA E BUXHETIT TË BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË VITI 2014

Buxheti i Bashkisë dhe Institucioneve të Vartësisë për vitin 2014 është miratuar me VKB nr. 16 datë 03.03.2014. Zbatimi i këtij buxheti gjatë vitit është bazuar në ligje, VKM, udhëzime, VKB si dhe akte ligjore dhe nënligjore dhe konkretisht:

- Ligjin nr 185/2013 datë. 02.12.2013 "Për buxhetin e vitit 2014".
- Udhëzimin nr. 2 datë 6.02.2012 i Ministrisë së Financave «Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit»
- Udhëzimin plotësues nr. 3 datë 17.01.2014 i Ministrisë së Financave «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014»
- Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".
- Ligjin 8652, dt 31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore".
- Ligjin nr 9632 datë. 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.
- Ligji 181/2013 datë 28.12.2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.
- Udhëzimi i MF nr. 32 datë 31.12.2013 "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël".
- Qarkore nr. 1 datë 24.12.2009 të Drejtorisë së Përgjithshme të tatimeve "Për përcaktimin e procedurave për kalimin e subjekteve si subjekt të TVSH-së".
- VKM nr. 573 datë 3.07.2013 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", i ndryshuar.
- Ligji nr. 10160 datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit publikë", i ndryshuar.
- Ligjit 8756 dt. 26.03.2002 "Për emergjencat civile", i ndryshuar.
- Ligji 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar.
- V.K.M nr 1 datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.
- Ligji nr 9780 datë 16.07.2007 "Për Inspektoriatin e Ndërtimit", i ndryshuar.
- Ligji nr 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".
- VKM nr 502 datë 16.04.2008 "Për administrimin e personelit të konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar", i ndryshuar.
- VKM nr. 1619 dt. 02.07.2008 të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", i ndryshuar.
- Ligji 7703 dt 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- VKM nr. 929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndyshuar.
- VKM nr. 1198 datë 03.12.2009 “Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre”.
- VKM nr. 997 datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.
- VKM 870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.
- VKM nr. 258 datë 03.06.1999 “Për një ndryshim në VKM nr 243 datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”.
- VKM nr. 228 datë 23.04.2004 “Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore.
- VKM nr. 511 datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore “, të ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 16 datë 20.7.2011 “Mbi zbatimin e VKM 463 datë 16.6.2011” të KM.
- Ligji nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
- Udhëzimin nr. 30 date 27.12.2011 “ Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik”
- VKM nr 1532 datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Korçë, të Qarkut Korçë”
- Ligjin nr. 8224 datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunave”, i ndyshuar
- Urdhërin Nr. 52, të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit datë 29.4.2003.
- Ligji 10119 date 23.04.2009 “Per planifikimin e territorit”
- Ligji 9482 date 03.04.2006 “Per legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje”, te ndryshuar
- VKM nr.1180 datë 05.08.2008 “Per përcaktimin e vleres se tarifes se shërbimit per legalizimin dhe mbledhjen e administrimin e te ardhurave te procesit te legalizimit”.
- Udhëzimin nr. 37 date 20.11.2008 “Per përdorimin e te ardhurave nga procesi i legalizimit”
- Ligji nr. 9869 datë 4.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 35 datë 05.11.2008.
- V.K.B. nr 19 dhe 20 dt. 29.03.2013 “Mbi miratimin e strukturës së administratës së Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë”.
- VKB të miratuara gjatë vitit, urdhra të Kryetarit të Bashkisë dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore të vitit 2014.

Burimet kryesore të financimit të Buxhetit për vitin 2014 kanë qenë:

- Të ardhurat e trashëguara të vitit 2013
- Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore
- Të ardhurat e institucioneve të vartësisë
- Transferta e pakushtëzuar
- Huamarrja vendore (kredia)
- Sponsorizime të ndryshme

Për vitin 2014 të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore u planifikuan në vlerën 456,196 mijë lekë. Gjatë vitit 2014 ky plan pësoi ndryshime dhe shkoi në vlerën 483,865 mijë lekë. Realizimi gjatë vitit 2014 ka qenë në vlerën 299,375 mijë lekë ose në masën 61.9%.

Të ardhurat nga institucionet e vartësisë janë planifikuar në vlerën 17,379 mijë lekë dhe gjatë vitit 2014 ky plan pësoi ndryshime dhe shkoi në vlerën 33,078 mijë lekë. Realizimi ka qenë në vlerën 30,175 mijë lekë ose në masën 91.2%.

Në materialin e analizës së buxhetit do të paraqesim më të detajuar analizën e të ardhurave të bashkisë dhe Institucioneve të Vartësisë.

Burimet e financimit jepen si më poshtë:

Burimet e financimit	Vlera	% për çdo zë ndaj totalit
-Të ardhurat e trashëguara	41,727 mijë lekë	3.1%
-Transferta e pakushtëzuar	230,960 mijë lekë	17%
-Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	299,375 mijë lekë	22.1%
-Të ardhurat e institucioneve të varësisë	30,175 mijë lekë	2.2%
-Sponsorizime të ndryshme	17,301 mijë lekë	1.3%
-Huamarrja vendore(kredia)	149,000 mijë lekë	11%
-Fondi i zhvillimit të rajoneve	587,706 mijë lekë	43.3%
Total	1,356,244 mijë lekë	100%

Shpenzimet e realizuara për vitin 2014 jepen si më poshtë:

Shpenzimet	Vlera	% për çdo zë ndaj totalit
-Shpenzime personeli	178,034 mijë lekë	15.7%
-Shpenzimet operative dhe shërbime publike	265,898 mijë lekë	23.5%
-Shpenzime (principali & interesi)	18,170 mijë lekë	1.6%
-Subvencione	6,398 mijë lekë	0.6%
-Transferta tek organizata të ndryshme	46,262 mijë lekë	4.1%
-Transferta tek individët	2,260 mijë lekë	0.2%


-Shpenzime kapitale	613,821 mijë lekë	54.3%
Total	1,130,843 mijë lekë	100%

Transferta e pakushtëzuar

Për vitin 2014 transferta e pakushtëzuar ka qenë në vlerën 230,960 mijë lekë. Ecuria e transfertës së pakushtëzuar jepet si më poshtë:

Vitet	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Transferta e pakushtëzuar (grandi)	166,785	186,488	171,127	167,287	171,421	177,165	230,960
Total	166,785	186,488	171,127	167,287	150,337	177,165	230,960

Paraqitja grafike



Transferta e pakushtëzuar është përdorur sipas Udhëzimit plotësues nr. 3 datë 17.01.2014 i Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014" duke respektuar ndarjen në 3-mujore si më poshtë: tremujori i parë 35%, i dyti 20%, i treti 20% dhe i katërti 25%.

Në shpenzimet e personelit administrativ është përdorur 15% e kësaj transferte.

REALIZIMI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARTESISË PËR VITIN 2014

Në tabelën e mëposhtme jepet realizimi i të ardhurave të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë për vitin 2014

Emertimi	Bashkia	NSHP	KI Shmsport	KI Shmsp spons	Q Artit dhe Kultures	NSHMAC	Sht eFoshnjes	NJMBQS	Qendra Ditore	Qendra Rezid	Total
Ardhurat	493,184,515	16,833,614	166,880	100,000	2,204,200	11,565,586	94,400	8,273,469	52,300	14,880	532,489,844
D ne buxhet	-2,525,183		-54,380			-31,934	-38,080		-5,230		-2,649,577

5% gar pun	-33,984,514										-33,984,514
Sponsorizime	-16,572,859				-688,000		-40,000				-17,300,859
Kredia	149,000,000										149,000,000
VI e mb e te Ardhurave	291,101,959	16,833,614	112,500	100,000	1,516,200	11,533,652	16,320	8,273,469	47,070	14,880	329,549,664
Celja Jan-Dhj	269,847,072	16,780,146	112,500	100,000	1,369,450	10,944,779	16,320		42,570	6,380	299,219,217
Te ardh te pashperndara	21,254,887	53,468	0	0	146,750	588,873	0	8,273,469	4,500	8,500	30,330,447

Sipas kësaj tabele, totali i të ardhurave të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë për vitin 2014 ka qenë 329,549,664 lekë, nga të cilat 299,219,217 lekë janë çelur dhe u përdorën për realizimin e shpenzimeve sipas buxhetit të miratuar për vitin 2014.

Totali i të ardhurave të trashëguara të vitit 2014 paraqitet në tabelën e mëposhtme në vlerën prej 225,403,163.02 lekë, nga të cilat 30,330,447.93 lekë janë nga të ardhurat e realizuara gjatë muajit dhjetor, 3,411,676.8 lekë të ardhura nga sponsorizimet, 126,693,260 lekë janë të ardhura nga huamarrja vendore (kredia), 52,117,287 lekë janë të ardhura nga fondi i zhvillimit të rajoneve dhe 12,850,491.29 lekë nga shpenzimet e fundvitit dhe do të përdoret për të shlyer detyrimet e vitit 2014 dhe realizimin e shpenzimeve të buxhetit të vitit 2015.

Institucionet	Mbartur nga shpenzimet	Mbartur nga te ardhurat	Mbartur nga sp(ardh)	Mbartur nga sp(shp)	Te ardh te trash viti 2014
Cerdhja	208,959.00	60,600.00			269,559.00
Arsimi 9 vj	321,327.00	366,590.00			687,917.00
Arsimi I mesem	47,174.00	17,350.00			64,524.00
Arsimi prof	283,006.00	66,138.00			349,144.00
Klubi shumesportesh	642,837.00	25,000.00		2,855.00	670,692.00
Klubi I futbollit	457,434.00				457,434.00
Qendra e kultures	1,367,955.00	7,000.00			1,374,955.00
Teatri	1,029,327.00	76,750.00			1,106,077.00
Biblioteka	537,834.00	63,000.00			600,834.00
NJMBQS	216,098.00	8,273,469.04			8,489,567.04
Nshp	4,258,696.00	53,468.00			4,312,164.00
Bashkia	2,901,841.29	21,308,082.89		3,330,840.80	27,540,764.98
Fondi I zhvillimit te rajoneve	52,117,287.00				52,117,287.00
Huaja bankare	126,693,260.00				126,693,260.00
Sherbimi urban	90,840.00				90,840.00
Sherbimi I pastrimit	13,407.00				13,407.00
Miremb varrez publ dhe desh	340,382.00				340,382.00
Qendra rezidenciale	29,150.00	8,500.00			37,650.00
Qendra ditore	67,032.00	4,500.00			71,532.00
Shtepia e foshnjes	37,192.00			77,981.00	115,173.00
Totali	191,661,038.29	30,330,447.93	0.00	3,411,676.80	225,403,163.02


PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2014**TAKSA MBI NDËRTESEN**

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
1	Taksa mbi ndërtesën	70 000 000	67 425 174	96 %

Taksa mbi ndërtesën për vitin 2014 ishte planifikuar 70 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 96% ose në vlerë 67 425 174 lekë, shumë kjo e arkëtuar nga subjekte të Biznesit të Madh dhe Biznesit të Vogël në vlerën 45 649 429 lekë , nga familjarët për vitin 2014 në vlerën 21 775 745 lekë. Diferenca e pa realizuar është si rezultat i mos pagimit brenda afateve ligjore nga ana e subjekteve të Biznesit të Madh dhe Biznesit të Vogël për të cilët janë zbatuar dhe po zbatohen të gjitha masat shtrënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e të gjithë detyrimit të pa paguar. Gjithashtu një pjesë e kësaj difference vjen si rezultat dhe i mos pagimit të detyrimit nga familjarët brenda datës 31.12.2014, për të cilët po bëhet evidentimi i saktë duke rakorduar me UKKO dhe po meren të gjitha masat për likuidimin e detyrimeve. Deri në 31.01.2015 janë arkëtuar në total detyrime të vitit 2014 vlera 895.480 lekë nga të cilat 199 730 lekë detyrime nga Biznesi i Madh dhe i Vogël dhe 695 750 lekë nga familjarët. Theksojmë se kemi arkëtuar nga subjektet dhe vlerën prej 394.800 lekë, e cila është kaluar për llogari të KLSH.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës mbi ndërtesën për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Taksa mbi ndërtesën	38 952 207	38 420 552	43 777 278	45 728 925	67 425 174



TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
2	Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	6 500 000	5 663 311	87 %


Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme e cila planifikohet dhe mbledhet nga agjenti tatimor i cili është ZVRPP Korçë, për vitin 2014 është planifikuar 6.500.000 lekë dhe është realizuar në masën 87 % ose e shprehur në vlerë 5.663.310.63 lekë. Duke filluar nga muaji janar 2014 e në vazhdim duke patur për qëllim rritjen e transparencës midis dy institucioneve, fuqizuar nivelin e bashkëpunimit si dhe monitorimin e performancës së ZVRPP Korçë në lidhje me zërin tatim shitjeje pasuri e paluajtshme përveç akt rakordimit mujor kemi kërkuar dhe na janë vënë në dispozicion evidenca të detajuara me numrin, sipërfaqen dhe vlerën e objekteve të cilat kanë ndëruar pronësinë për çdo muaj.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014 :

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	5 717 266	5 129.970	3 828 227	6 461 126	5 663 311

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

■ VITI ■ Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme



TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
3	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël	100 000 000	41 487 797	41 %


Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël në buxhetin e vitit 2014 është planifikuar 100 000 000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2014 është në masën 41 % ose në vlerë 41 487 797 lekë, nga të cilat 5 425 607 lekë janë arkëtuar nga ana e Bashkisë Korçë nga subjektet e Biznesit të Vogël detyrime këto nga vitet paraardhëse si taksë vendore dhe 36 062 190 lekë janë derdhur për llogari të Bashkisë Korçë nga DRT Korçë nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël ku kjo e fundit është në rolin e agjentit tatimor.

Ky nivel kaq i ulët i realizimit të të ardhurave për vitin 2014 është si pasojë e ndryshimit të Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" të ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 32 datë 31.12.2013, i ndryshuar, ku subjektet me xhiro vjetore 0 deri në 2 milion lekë paguajnë tatimin e thjeshtuar të Biznesit të Vogël në vlerën 25 000 lekë dhe për pjesën e subjekteve të cilët realizojnë një qarkullim vjetor nga 2 deri në 8 milionë lekë parapaguajnë tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, të ndarë në katër këste vjetore. Shuma vjetore e parapagimeve llogaritet duke marrë parasysh qarkullimin gjithsej dhe fitimin e tatueshëm të një viti më parë të deklaruar nga tatimpaguesi, bazuar në deklaratën vjetore të të ardhurave personale të biznesit të vogël, të bërë në zbatim të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar dhe pjesa më e madhe e këtyre subjekteve kishin deklaruar qarkullim vjetor deri në 2 milion lekë dhe sipas legjislacionit në fuqi duhet të paguanin 25 000 lekë. Kjo gjë është kundërshtuar nga ana jonë duke i paraprirë situatës që do të ndodhte në vazhdim në

realizimin e këtij zëri dhe i është kërkuar DRT Korçë në mënyrë të përsëritur të bënte monitorimin e xhiros së subjekteve me qëllim deklarimin real të të ardhurave dhe pagimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin sipas qarkullimit real pasi nga të dhënat që ne dispononim duke i krahasuar dhe me nivelin e qarkullimit vjetor të parashikuar dhe parapagimit të bërë nga ana e tyre pranë Bashkisë Korçë të një viti më parë deklarimet e tyre nuk ishin reale.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës vendore të Biznesit të Vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël për vitet 2010 – 2011– 2012 – 2013 dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël për 2014:

VITI	2010	2011	2012	2013	2014
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël	96,085,337	93,874,914	89,192,648	82,769,863	41,487,797



TAKSA E REGJISTRIMIT TE PERVITSHEM TE MJETEVE TE TRANSPORTIT RRUGOR


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
4	Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor	24 000 000	16 648 777	69 %

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor e cila planifikohet dhe mbledhet nga agjenti tatimor i cili është D.R.SH.T.RR Korçë, për vitin 2014 është planifikuar 24 000 000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2014 është në masën 69 % ose në vlerë 16 648 777 lekë. Duke filluar nga muaji janar 2014 e në vazhdim duke patur për qëllim rritjen e transparencës midis dy institucioneve, fuqizuar nivelin e bashkëpunimit si dhe monitorimin e performancës së D.R.SH.T.RR Korçë në

lidhje me këtë zë përveç akt rakordimit mujor kemi kërkuar dhe na janë vënë në dispozicion evidenca të detajuara me numrin dhe pronësinë e mjeteve si dhe vlerën e paguar për çdo mjet, për çdo muaj.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor për vitet 2010 – 2011 -2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor	14 805 564	15 501 348	23 380 418	21 497 777	16 648 777



TARIFË REGJISTRIM BIZNESI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
5	Tarifë regjistrim biznesi	4.000.000	3.165.000	79 %

Tarifë regjistrim biznesi për leje ushtrim veprimtarie për vitin 2014 është planifikuar


4 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 79 % ose në vlerën 3 165 000 lekë, kjo si rezultat i regjistrimit dhe pagimit nga ana e 235 subjekteve të reja gjatë vitit 2014, në vlerën

2 637 500 lekë dhe nga pagimi i 34 subjekteve të regjistruara në vitet e mëparshme në vlerën 527 500 lekë. Diferenca e pa realizuar është si rezultat i mos pagimit brenda afateve ligjore nga ana e subjekteve të Biznesit të Madh dhe Biznesit të Vogël për të cilët janë zbatuar dhe po zbatohen të gjitha masat shtënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e të gjithë detyrimit të pa paguar. Deri në 31.01.2015 nga masat e ndërmara është arkëtuar në total detyrime të vitit 2014 vlera 152.500 lekë. Gjithashtu duhet theksuar se ulja e kësaj tarife nga 20 000 lekë në 15 000 lekë për Biznesin e Madh dhe nga 15 000 lekë në 10 000 lekë për Biznesin e Vogël si dhe nga puna e vazhdueshme

e inspektorëve të drejorisë së të ardhurave viti 2014 ka qënë viti me numrim më të madh të subjekteve të regjistruara krahasuar kjo nga viti 2010.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së regjistrimit të biznesit për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014 :

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Tarifë regjistrim biznesi	3 650 000	3 020 000	2 746 500	2 770 000	3 165 000




TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
6	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	31 920 000	1 695 305	5 %

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2014 është planifikuar 31 920 000 lekë, dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 5 % ose në vlerë 1 695 305 lekë. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitet më përpara ka zënë një peshë mjaft të rëndësishme në të ardhurat e Bashkisë Korçë. Mos realizimi i kësaj takse për vitin 2014, ka ardhur për faktin se nuk ka patur miratime lejesh zhvillimore ndërtimi, për arsye të pezullimit të tyre në zbatim të vendimit të KKT-së Nr.1, datë 22.08.2014 “Për harmonizimin e instrumentave të planifikimit vendor në funksion të ndarjes së re administrative - territoriale”.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	71 591 960	67 162.277	4 929 863	118 347	1 695 305



TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA LEGALIZIMET

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	34 916 442	449 262	1 %


Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2014 është planifikuar 34 916 442 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 1 % ose në vlerë 449 261,61 lekë.

Planifikimi fillestar i kësaj takse prej 61 982 000 lekë i kryer në vitin 2009 u bë nga specialistët e Bashkisë Korçë të cilët krijuan dosjet për çdo objekt në proces legalizimi si dhe afatet kohore për kryerjen e këtij procesi bazuar në vlerat konform legjislacionit në fuqi në atë kohë në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Por kalimi i procesit të legalizimeve nga kompetencë e pushtetit vendor në atë të pushtetit qendror si dhe reduktimi i ndjeshëm me ligj gjatë vitit 2009 i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, bëri që shqyrtimi i dosjeve të krijuara nga strukturat përkatëse të Bashkisë Korçë me objektet në proces legalizimi të cilat ju kaluan ALUZN – it Qarku Korçë për procedim të mëtejshëm, të ecte jashtëzakonisht ngadalë fakt i cili duket edhe në arkëtimet e kryera në lidhje me këtë taksë gjatë ketyre viteve. Procesi i legalizimeve filloi në fund të vitit 2008 dhe viti 2009 ishte viti i parë që nga ana jonë u planifikua taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Mos realizimi i kësaj takse për vitin 2014, ka ardhur për faktin se ka ndryshuar dhe legjislacioni në fuqi. Gjithashtu dhe për arsyen se nga ana e ALUZN-it Qarku Korçë nuk na është dërguar një planifikim real i të ardhurave për vitin 2014, panvarësisht komunikimit tonë shkresor dhe në këto

rrethana planifikimi është bërë mbi bazën e planifikimit fillestar duke zbritur realizimin e çdo viti.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	3 088 276	4 671 413	4 563 743	2 735 018	449 262



TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJE TRANSPORTI


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
8	Tarifë regjistrimi për leje transporti	500.000	493.880	99%

Tarifë regjistrimi leje transporti për vitin 2014 është planifikuar **500 000** lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 99 % ose në vlerë **493 880** lekë, nga të cilat 31 630 lekë nga transporti i mallrave, 30 750 lekë nga transporti i udhëtarëve me autobusë (ndërqytetës & rrethqytetës), 238 000 lekë nga transporti i udhëtarëve me taksì dhe 193 500 lekë nga autorizimet për automjete të tonazhit të lartë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së regjistrim për leje transporti për vitet 2010 – 2011 -2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
------	------	------	------	------	------

Tarifë regjistrimi për leje transporti	2 140 810	2 841 470	853 305	220 940	493 880
--	-----------	-----------	---------	---------	---------



TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
9	Taksa e fjetjes në hotel	2 500 000	1 666 638	67%

Taksë fjetje në hotel për vitin 2014 është parashikuar 2 500 000 lekë dhe është realizuar në masën 67% ose në vlerën 1 666 638 lekë, këto nga subjektet me aktivitet hotel që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin administrativ të Bashkisë Korçë. Diferenca e pa realizuar është si rezultat i mos pagimit brenda afateve ligjore nga ana e subjekteve për të cilët janë zbatuar dhe po zbatohen të gjitha masat shtënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e të gjithë detyrimit të pa paguar. Deri në 31.01.2015 janë arkëtuar në total detyrime të vitit 2014 vlera 303 895 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksë fjetje në hotel për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Taksa e fjetjes në hotel	937 192	1 730 389	1 886 089	1 786 448	1 666 638




TAKSË THERRE BAGËTIE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
10	Taksë therre bagëtie	800 000	754 600	94%

Taksë therre bagëtie për vitin 2014 është planifikuar 800 000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2014 është në masën 94 % ose në vlerën 754 600 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës therre bagëti për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014 :

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Taksë therre bagëtie	711 100	619 850	761 150	744 600	754 600




TAKSA E REKLAMËS

Nr	Lloji i Taksës ose Tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
11	Taksa e Reklamës	18 000 000	18 551 722	103 %

Taksa e reklamës për vitin 2014 është planifikuar 18 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 103 % ose në vlerë 18 551 722 lekë. Kjo taksë është realizuar në masën 103% si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese të ndërmara nga ana e Bashkisë Korçë ndaj subjekteve debitore ndër vite si dhe nga evidentimi i saktë i të gjitha sipërfaqeve reklamuese të ndodhura në qytetin e Korçës.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së reklamës për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Taksa e Reklamës	14 558 562	13 365 875	13 103 438	13 744 478	18 551 722



TAKSA E TABELËS


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
12	Taksa e Tabelës	250 000	250 970	100 %

Taksa e tabelës për vitin 2014 është planifikuar 250 000 lekë dhe është realizuar në masën 100% ose në vlerë 250 970 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së tabelës për vitet 2010 – 2011 -2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Taksa e tabelës	1 942 220	254 770	261 280	247 250	250 970

Taksa e tabelës




TARIFË MUR PERIMETRAL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
13	Tarifë mur perimetral	100 000	23 000	23 %

Tarifë mur perimetral për vitin 2014 është planifikuar 100 000 lekë dhe është realizuar në masën 23% ose në vlerë 23 000 lekë. Mos realizimi i kësaj takse për vitin 2014, ka ardhur për faktin se nuk ka patur miratime lejesh zhvillimore ndërtimi, për arsye të pezullimit të tyre në zbatim të vendimit të KKT-së Nr.1, datë 22.08.2014 “Për harmonizimin e instrumentave të planifikimit vendor në funksion të ndarjes së re administrative - territoriale”.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës mur perimetral për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Tarifë mur perimetral	995 680	845 680	87 410	0	23 000



TARIFË PËR SHËRBIM ME TAVOLINA JASHTË LOKALIT


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
14	Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit	2 500 000	2 595 300	104 %

Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit për vitin 2014 është parashikuar 2 500 000 lekë dhe është realizuar në masën 104 % ose në vlerën 2 595 300 lekë. Kjo taksë është realizuar në masën 104% si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese të ndërmara nga ana e Bashkisë Korçë si dhe në evidentimin e saktë nga ana e inspektorëve të numrit të tavolinave të biznesit të vogël dhe të madh që vendosen jashtë ambjenteve të lokaleve gjatë stinës së verës.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës për shërbim me tavolina jashtë lokalit për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014 :

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit	2 566 700	1 968 500	2 741 275	2 022 300	2 595 300

Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit




TARIFA E PASTRIMIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
15	Tarifa e Pastrimit	58 000 000	62 825 304	108 %

Tarifa e pastrimit për vitin 2014 është planifikuar 58 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 108 % ose në vlerën 62 825 304 lekë. Kjo taksë është realizuar në masën 108% si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese të ndërmara nga ana e Bashkisë Korçë për subjektet debitore por dhe punës së përditshme të punonjësve të Departamentit të të Ardhurave dhe Kontrollit të Teritorit. Kjo shumë është arkëtuar nga subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 28 360 980 lekë, nga familjet në vlerën 34 142 203 lekë të cilët e paguajnë këtë tarifë tek fatura e ujit dhe në vlerën 200 221 lekë nga familjet të cilat nuk kanë kontratë furnizimi me ujë me UKKO dhe si rezultat nuk paguanin tarifën e pastrimit por nga bashkëpunimi me institucionet e tjera dhe puna e punonjësve të bashkisë është bërë e mundur evidentimi dhe arkëtimi i kësaj tarife dhe nga institucionet shtetërore në vlerën 121 900 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së pastrimit për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Tarifa e Pastrimit	53 701 508	40 344 535	49 719 607	58 843 384	62 825 304



TARIFË SHËRBIMI , VËRTETIME ,ÇERTIFIKATA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
16	Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata	6 000 000	10 526 585	175 %


Të ardhura të tjera (tarifa shërbimi, vërtetime, çertifikata, etj), për vitin 2014 është planifikuar 6 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 175 % ose në vlerën 10 526 585 lekë. Sqarojmë se ky zë është realizuar në masën 175% pasi kemi pasur të ardhura nga shitja e aktiveve të UMB-së.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifave të shërbimit, vërtetime, çertifikata, etj për vitet 2010 – 2011- 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata	4 718 240	3 237 085	5 991 427	5 925 621	10 526 585

Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata

■ VITI ■ Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata




TARIFË PARKIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
17	Tarifë Parkimi	24 249 680	5 480 070	23%

Tarifë parkimi për vitin 2014 është planifikuar **24 249 680** lekë dhe deri në fund të vitit 2014 është realizuar në masën 23 % ose në vlerë **5 480 070** lekë. Në mos realizimin e kësaj tarife ndikimin kryesor e ka pasur mos përdorimi i vendeve të parkimit në zonën e Teatrit dhe atë të Pazarit të qytetit. Pasi pothuajse që në nisje të aktivitetit të subjektit të kontraktuar filluan punimet në sheshin e Teatrit (u shfrytëzuan vendparkimet vetëm para Teatrit deri në mesin e muajit gusht). Gjithashtu filluan punimet në rr. “Kiço Greço”, pranë ndërprerjes me rr. “Viktimat e 7 Shkurtit”, duke u zhvendosur në drejtim të bul. “Fan Noli” dhe në rr. “Ismail Qemali”. Pra nga zonat kryesore prej nga pritej të realizohej kjo tarifë, vendparkimet pothuajse nuk janë shfrytëzuar. Gjithashtu dhe koeficienti i shfrytëzimit të vendit të parkimit ishte më i ulët se parashikimi.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të Tarifës së Parkimit për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Tarifë Parkimi	4 233 170	2 779 935	2 422 740	1 943 306	5 480 070




GJOBA POLICIA BASHKIAKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
18	Gjoba Policia Bashkiake	400 000	22 000	6 %

Gjoba Policia Bashkiake për vitin 2014 është planifikuar 400 000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2014 është në masën 6% ose në vlerën 22 000 lekë. Numri i vogël i masave administrative të vendosura nga Policia Bashkiake për vitin 2014 ka ardhur si pasojë e mungesës shumë të theksuar të numrit të efektivave të Policisë Bashkiake.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të zërit gjoba Policia Bashkiake për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014 :

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Gjoba Policia Bashkiake	334 600	64 500	42 000	19 000	22 000




GJOBA TË BIZNESIT TË VOGËL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
19	Gjoba të biznesit të vogël	700 000	447 455	64 %

Gjoba të biznesit të vogël për vitin 2014 është planifikuar 700 000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2014 është në masën 64 % ose në vlerën 447 455 lekë. Duhet theksuar se ky zë në këtë masë është realizuar vetëm nga subjektet debitoare të biznesit të vogël të krijuar deri në vitin 2013 kur këto subjekte paguanin pranë Bashkisë Korçë taksën vendore të biznesit të vogël. Gjithashtu theksojmë që për vitin 2014 në zbatim të VKB nr.6 datë 05.02.2014 "PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE DHE ADMINISTRIMIN E TYRE NË QYTETIN E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET", por dhe lehtësimit të barrës fiskale të biznesit të vogël duke ecur në një linjë me masat lehtësuese të aplikuara nga pushteti qendror nuk janë aplikuar gjoba.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të gjobave të biznesit të vogël për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Gjoba të biznesit të vogël	1 230 374	675 761	619 873	757 239	447 455



GJOBA TË INSPEKTORIATIT NDËRTIMOR VENDOR

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
20	Gjoba të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor	2 500 000	1 390 000	56 %


Gjoba të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor për vitin 2014 është planifikuar 2.500.000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2014 është në masën 56 % ose në vlerë 1 390 000 lekë si dhe janë në proces vjeljeje nga ana e përmbarimit dhe vlera 780 000 lekë

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të gjobave të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014 :

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Gjoba të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor	200 000	150 000	1 120 000	2 030 000	1 390 000

Gjopa të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor

■ VITI ■ Gjopa të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor



GJOBA TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
21	Gjopa të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit	150 000	33 000	22 %

Gjopa të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për vitin 2013 është planifikuar 150 000 lekë, dhe është realizuar në masën 22 % ose në vlerën 33.000 lekë. Duket qartë që panvarësisht planifikimt në këtë vlerë gjatë punës së përditshme të inspektorëve nuk janë konstatuar shkelje administrative kjo si rezultat dhe i ndërgjegjësimit qytetar.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të gjobave të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Gjopa të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit	60 000	72 000	125 000	55 000	33 000

Gjopa të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit



QERA OBJEKTI


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
22	Qira Objekti	1 707 740	1 055 032	61%

Qira objekti për vitin 2014 është planifikuar 1 707 740 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2014 është në masën 61 % ose në vlerën 1 055 032 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të zërit qira objekti për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Qira objekti	747 319	672 005	1 550 338	819 935	1 055 032

Qira objekti




QERA SIPËRMARRJE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
23	Qira sipërmarrje	432 000	432 000	100 %

Qira sipërmarrje për vitin 2014 është planifikuar 432 000 lekë dhe është realizuar në vlerën 432 000 lekë në masën 100 %.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të zërit qira sipërmarrje për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Qira sipërmarrje	1 100 336	0	864 000	396 000	432 000




TARIFË PLAN VENDOSJE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
24	Tarifë plan vendosje	100 000	192 000	192 %

Tarifë plan vendosje për vitin 2014 është planifikuar 100 000 lekë, dhe është realizuar në masën 192 % ose në vlerën 192 000 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së plan vendosjes për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014 :

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Tarifë plan vendosje	177 000	96 000	0	0	192 000




TARIFË NDRIÇIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
25	Tarifë Ndriçimi	23 000 000	23 704 862	103 %

Tarifë ndriçimi për vitin 2014 është planifikuar 23 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 103 % ose në vlerën 23 704 862 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 10 774 562 lekë , nga familjet në vlerën 12 618 376 lekë të cilët e paguajnë këtë tarifë tek fatura e ujit dhe në vlerën 76 924 lekë nga familjet të cilat nuk kanë kontratë furnizimi me ujë me UKKO dhe si rezultat nuk paguanin tarifën e ndriçimit por nga bashkëpunimi me institucionet e tjera dhe puna e punonjësve të bashkisë është bërë e mundur evidentimi dhe arkëtimi i kësaj tarife dhe nga institucionet shtetërore në vlerën 235 000 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së ndriçimit për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Tarifë Ndriçimi	14 461 572	11 178 626	15 424 960	17 774 748	23 704 862


**TARIFË GJELBËRIMI**

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
26	Tarifë Gjellbërimi	15 000 000	15 503 114	103 %

Tarifë gjellbërimi për vitin 2014 është planifikuar 15 000 000 lekë, dhe është realizuar në masën 103 % ose në vlerën 15 503 114 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 6 144 060 lekë, nga familjet në vlerën 9 069 314 lekë të cilët e paguajnë këtë tarifë tek fatura e ujit dhe në vlerën 54 740 lekë nga familjet të cilat nuk kanë kontratë furnizimi me ujë me UKKO dhe si rezultat nuk paguanin tarifën e gjellbërimit por nga bashkëpunimi me institucionet e tjera dhe puna e punonjësve të bashkisë është bërë e mundur evidentimi dhe arkëtimi i kësaj tarife dhe nga institucionet shtetërore në vlerën 235 000 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së gjellbërimit për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Tarifë Gjellbërimi	9 119 317	7 270 496	10 545 989	12 084 451	15 503 114



TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONAT PUBLIKE


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
27	Tarifë për servitutin e kalimit në pronat publike	600.000	679.464	113 %

Tarifë për servitutin e kalimit në pronat publike për vitin 2014 është planifikuar 600 000 lekë dhe është realizuar në masën 113 % ose në vlerën 679 464 lekë. Ky realizim ka ardhur si rezultat bazuar në të dhënat e marra nga inspektorët të cilët kanë inventarizuar dhe matur në terren sipërfaqet që kanë zënë prona publike.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës për servitutin e kalimit në pronat publike për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Tarifë për servitutin e kalimit në pronat publike	684 932	301 860	377 060	337 820	679 464

Tarifë për servitutin e kalimit në pronat publike



TARIFË PËRDORIMI I TREGUT TË LIRË TË QYTETIT


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
28	Tarifë përdorimi i tregut të lirë të qytetit	5 500 000	4 262 690	78 %

Tarifë përdorimi tregu i lirë i qytetit për vitin 2014 është planifikuar 5 500 000 lekë dhe është realizuar në masën 78 % ose në vlerën 4 262 690 lekë. Ky realizim në këtë masë vjen nga largimi nga hapësira publike i tregëtarëve ditorë që tregëtonin tek “trotuari i mesit”, tek sheshi ku tregëtohej duhani, ata paralel me rrugën “Kiço Kreço” si dhe ata tek sheshi i tregut industrial si pasojë e investimeve në këtë zonë. Bazohet në inspektimet dhe verifikimet që janë kryer për zënien e pronës publike dhe shfrytëzimin e tyre nga ana e tregëtarëve që ushtrojnë aktivitetin në këtë treg. Ky planifikim është me ulje krahasuar me realizimin e vitit 2014 pasi janë larguar nga hapësira publike tregëtarët ditorë që tregëtonin tek “trotuari i mesit”, ata paralel me rrugën “Kiço Kreço” si dhe ata tek sheshi i tregut industrial.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së përdorimit të tregut të lirë të qytetit për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Tarifë përdorimi i tregut të lirë të qytetit	11 953 790	10 721 136	5 316 780	501 160	4 262 690

Tarifë përdorimi i tregut të lirë të qytetit




TARIFË LEJE PËRDORIMI KANTINA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
29	Tarifë leje përdorimi kantina	900 000	915 100	102 %

Tarifë leje veprimtarie kantina për vitin 2014 është planifikuar **900 000** lekë dhe është realizuar në masën 102 % ose në vlerën **915 100** lekë. Ky realizim vjen si shkak i arkëtimit të të gjitha detyrimeve brenda afateve ligjore të të gjitha kantinave të ndodhura në qytetin e Korçës.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të zërit tarifë së leje përdorimi kantina për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Tarifë leje përdorimi kantina	1 134 000	948 600	1 081 351	824 450	915 100



TARIFË PËR EKSPOZIM MALLI JASHTË DYQANIT


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
30	Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit	1 000 000	1 120 100	112 %

Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit për vitin 2014 është planifikuar 1 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 112 % ose në vlerën 1 120 100 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i punës së kryer nga inspektorët të cilët kanë inventarizuar dhe matur në terren sipërfaqet ekspozuese të mallit jashtë dyqanit dhe kanë arkëtuar detyrimet brenda afateve ligjore.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës për ekspozim malli jashtë dyqanit për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit	799 200	843 264	981 150	714 750	1 120 100

Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit



TAKSË PËR ZËNIE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
31	Taksë për zënien e hapësirave publike	400 000	447 965	112 %

Taksë për zenie hapësire publike për vitin 2014 është planifikuar 400 000 lekë dhe është realizuar në masën 112 % ose në vlerën 447 965 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i punës së kryer nga inspektorët të cilët kanë inventarizuar dhe matur në terren sipërfaqet për zënien e hapësirave publike dhe kanë arkëtuar detyrimet brenda afateve ligjore.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës për zënie hapësire publike për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014 :

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Taksë për zënien e hapësirave publike	0	0	283 457	355 005	447 965

Taksë për zënien e hapësirave publike




TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
32	Taksa mbi tokën bujqësore	1 000 000	949 248	95 %

Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2014 është planifikuar 1 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 95 % ose në vlerën 949 248 lekë. Në lidhje me debitorët e krijuar kanë filluar të ndiqen procedurat e mbledhjes të detyrimeve gjatë vitit 2014 konform legjislacionit në fuqi. Ky realizim vjen si rezultat i arkëtimit të detyrimeve dhe nga debitorët e viteve të mëparshme.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës mbi tokën bujqësore për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Taksa mbi tokën bujqësore	0	0	3 760 957	439 137	949 248



TAKSË E PËRKOSSHME PËR LINJAT AJRORE DHE NËNTOKËSORE (TELEFONI, ENERGJI, TV KABLLORE, INTERNET)

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
33	Taksë e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore	3 000 000	0	0 %

Taksa e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore për vitin 2014 është planifikuar

3 000 000 lekë dhe gjatë vitit 2014 nuk ka pasur asnjë arktëmin për këtë taksë, por duhet theksuar se është bërë e mundur sigurimi në bankë dhe po vazhdojmë procedurat ligjore të arkëtimit të vlerës 1 872 000 lekë nga subjekti AlbTelecom. Gjithashtu me kalimin e CEZ shpërndarjes nga kompani private në shtetërore ky subjekt përjashtohet nga pagimi i kësaj takse.


TË ARDHURA NGA QIRATË (BANESAT SOCIALE)

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
34	Të ardhura nga qiratë (banesa sociale)	6 652 957	3 587 703	54 %

Të ardhurat nga qiratë, (banesa sociale) për vitin 2014 është planifikuar 6 652 957 lekë dhe është realizuar në masën 54 % ose në vlerën 3 587 703 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të ardhura nga qiratë (banesa sociale) për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Të ardhura nga qiratë (banesa sociale)	0	0	0	0	3 587 703



TË ARDHURA NGA SHITJA E NJËSIVE TË SHËRBIMIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
35	Të ardhura nga shitja e njësive të shërbimit	30 000 000	0	0 %

Të ardhurat nga shitja e njësive të shërbimit për vitin 2014 është planifikuar 30 000 000 lekë dhe gjatë vitit 2014 nuk ka pasur asnjë arkëtim për këtë taksë pasi dhe po gjatë këtij viti nuk u bë e mundur shitja e këtyre njësive të planifikuara.

TË ARDHURA NGA QERATË (BANESA NË PRONËSI TË BASHKISË ENTI I BANESAVE)

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2014	Realizimi 2014	Përqindja
36	Të ardhura nga qiratë (banesa në pronësi të bashkisë enti i banesave)	6.586.612	4.678.958,50	71 %

Të ardhurat nga qiratë, (banesa në pronësi të bashkisë enti i banesave) për vitin 2014 është planifikuar 6 586 612 lekë dhe është realizuar në masën 71 % ose në vlerën 4 678 958 lekë

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të ardhura nga qiratë (banesa në pronësi të bashkisë enti i banesave)për vitet 2010 – 2011 – 2012 – 2013 dhe 2014:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Të ardhura nga qiratë (banesa në pronësi të bashkisë enti i banesave)	0	0	0	0	4 678 958



REALIZIMI I SHPENZIMEVE TE BASHKISE PER VITIN 2014

Shpenzime për paga

Shpenzimet për paga për punonjësit e administratës së Bashkisë dhe Institucioneve të Vartësisë janë realizuar në bazë të VKM nr. 586 datë 17.7.2013 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619 dt. 02.07.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, VKM nr. 929 datë 17.11.2010 Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë si dhe VKM nr. 493 datë 6.7.2011 Për disa ndryshime në VKM 929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”.

Numri i punonjësve të administratës së Bashkisë për vitin 2014 ka qene 105.

Fondi i planifikuar për paga për vitin 2014 ishte në vlerën 73,100 mijë lekë. Gjithashtu duke iu referuar VKM nr. 826 datë 5.12.2011 "Për një ndryshim në VKM nr. 929 datë 17.11.2010 Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë të ndryshuar si dhe sipas Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë fondi i veçantë u përdor edhe për:

-110 mijë lekë për zhvillimin e aktivitetit me rastin e 8 marsit.

-154 mijë lekë u përdor për shpërblim dalje në pension për 3 punonjës

- 30 mijë lekë ndihmë për fatkeqësi për një punonjës.

Fondi i planifikuar i pagave me këto ndryshime, si dhe duke zbritur fondin në vlerën 731 mijë lekë, i cili u përdor për pagesën e 2 punonjësve në listë pritjeje, fondi i pagave i planifikuar shkoi në vlerën 72,075 mijë lekë. Realizimi për vitin 2014 ka qenë në vlerën 64,059 mijë lekë ose 88.9%.

Shpenzime për sigurime shoqërore

Fondi i planifikuar për vitin 2014 ka qenë në vlerën 11,700 mijë lekë. Realizimi i këtij fondi ka qenë në vlerën 10,678mijë lekë ose 91.3%. Ky fond u përdor sipas VKM nr 581 datë 17.7.2013 "Për disa ndryshime në VKM nr. 1114 datë 30.7.2008 për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703 datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, nr. 9136 datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe nr. 7870 datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe VKM nr 457 datë 9.7.2014 "Për disa ndryshime në VKM nr. 1114 datë 30.7.2008 për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703 datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, nr. 9136 datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe nr. 10383 datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar"

Shpenzimet operative (mallra dhe shërbime)

Fondi i planifikuar për shpenzime operative gjatë vitit 2014 ka qenë 45,145 mijë lekë dhe gjatë vitit ky fond ka pësuar ndryshime duke shkuar në 45,334 mijë lekë nga të cilat 40,663 mijë lekë ka qenë fondi i planifikuar i shpenzimeve operative për vitin 2014 dhe 4,671 mijë lekë kanë qenë detyrime nga viti 2013.

Realizimi i shpenzimeve operative për vitin 2014 ishte 31,440 mijë lekë ose 69.4%, në të cilën përfshihet edhe detyrimet e vitit 2013 prej 4,671 mijë lekë.

Analiza e detajuar e realizimit të shpenzimeve operative jepet në tabelën e mëposhtme.

SHPENZIME OPERATIVE	Det13	F14 det	PI 2014	PI ND14	Fakt14	Det 14	Fakt+Det 14	PL 14- Fakt 14	%
TELEKOM+POSTA	39	39	1,822	1,717	980		980	737	57%
ABONIM INTERNET ADSL			300	300	295		295	5	98%
TELEFON PA PAGESE			20	20			0	20	0%
ENERGJIA ELEKTRIKE			2,494	2,494	2,286		2,286	208	92%
PAGESE UJI			450	555	509		509	46	92%
UDHETIME DHE DIETA	188	188	550	900	894		894	6	99%
RIPARIM E PAJISJE MAKINASH	186	186	450	450	426		426	24	95%
KARBURANT MAKINA+NGROHJE	2,021	2,021	7,000	7,000	3,763	3,033	6,796	3,237	54%
PRODH DHE TRANSMETIM SPOTI DHE NJOFTIME			433	433	210		210	223	48%
PRODHIMI I REVISTES QYTETI IM	614	614	1,567	1,200	135	639	774	1,065	11%
MEREMETIME TE NDRYSHME	130	130	200	200	191		191	9	96%
SHPENZIME PRITJE			100	100	30		30	70	30%
MATERIALE ELEKTRIKE DHE HIDRAULIKE	159	159	250	250	227		227	23	91%
VEHJE, UNIFORMA POLICIA			200	200			0	200	0%
SIGURACION MAKINE NDERTESE DHE KONTROLL TEKNIK	30	30	200	300	215		215	85	72%
SHPENZIME TE TJERA	65	65	600	595	415	43	458	180	70%
ORGANIZIMI FESTES 8 MARSIT				110	110		110	0	100%
SHPENZIME Q.K.P. M.POTER			500	500	164	332	496	336	33%
LETET SHKRIMI FOTOKOPJIMI KANCELARI	25	25	480	480	400		400	80	83%
MATERIALE KONSUMI	45	45	200	200	186		186	14	93%
RIPARIM FOTOKOPJE DHE PAISJE TE NDRYSHME	198	198	200	200	25	79	104	175	13%
RUAJTJA E BASHKISE ETJ	638	638	3,100	3,100	2,805	256	3,061	295	90%
BOJE PRINTERI E FOTOKOPJUES	70	70	700	700	418		418	282	60%
SHPENZIME PER SHKOLLEN E MALTES			600	600	416	163	579	184	69%
VENDIME GJYQESORE			10,000	9,004	4,972		4,972	4,032	55%
REGJISTRIMI PRONAVE BASHKI			350	350	131		131	219	37%
BLLOQE ADMINISTRATIVE	45	45	400	400	337		337	63	84%
MAT PROMOCIO (FTESA, FLETEPALOSJE, KARTOLINA)	218	218	500	245	226		226	19	92%
MATERIALE NJOFTIMI DHE INFORMACION			150	150	5		5	145	3%
VIJEZIMI I RRUGEVE			2,733	2,268	1,668	600	2,268	600	74%
SHP MIREMB E PROGRAMIT TE MENAXHIMIT TE TAKSAVE			475	480	480		480	0	100%
DETYRIME PER ENERGIJE TE BANESAVE SOCIALE ME KOSTO TE ULET			555	605	605		605	0	100%
PRODHIM BILETA PARKIMI				420	58		58	362	14%
VLERESIMI I NDIKIMIT MJEDISOR				160	73		73	87	46%
TARIFE PJESMARRJE PANAIRI LEVIZES				75	71		71	4	95%
APLIKIMI I ARM				252	10		10	242	4%
BLERJE LIBRA TEKNIKE PER URBANISTIKE								0	#DIV/0!
SHPENZIME PER QENDER KOM PER TE MOSHUARIT p sociale				360	270	90	360	90	75%
KOMISION PER TATIMIN E THJESHTUAR TE BIZNESIT TE VOGEL			1,000				0	0	#DIV/0!

SHPENZIME PER QENDER KOM PER TE MOSHUARIT QERA AMBIENTI				400	300	100	400	100	75%
TOTAL SHPENZIME OPERATIVE	4,671	4,671	38,579	37,773	24,306	5,335	29,641	13,467	64%
Projekte	0	0	1,894	2,890	2,464	0	2,464	426	85%
SHER TE PRINTIMIT DHE PUBLIKIMIT			625	625	343		343	282	55%
SHPENZIME QERAMARRJE TE TJERA							0	0	#DIV/0!
SHPENZIME PRITJE PERCJELLJE			25	25			0	25	0%
SHPENZIME QERAMARRJE APARATE PAJI			1,140	140	140		140	0	100%
SHPENZIME QERAMARRJE FESTA E BIRRES 2013				996	996		996	0	100%
shp qeramarje led ëall festa e birres 2014				480	478		478	2	100%
shoë me lazer festa e birres 2014				480	475		475	5	99%
fishekzjarre festa e birres 2014				40	32		32	8	80%
SHPENZIME HONORARE								0	#DIV/0!
SHPENZIME TE TJERA DHE SHERBIME OPER			104	104	0		0	104	0%
SHPENZIME ENERGJI&UJE								0	#DIV/0!
SHPENZIME QERAMARRJE AMBIENTI							0	0	#DIV/0!
TOTALI SHPENZIME OPERATIVE+PROJEKTE	4,671	4,671	40,473	40,663	26,770	5,335	32,105	13,893	66%
SHLYERJA E KREDISE	13,720			28,622	18,170	0	18,170	10,452	63%
INTERESI	6,576			15,912	5,460		5,460	10,452	34%
PAGESE PRINCIPALI	7,144			12,710	12,710		12,710	0	100%
TOTAL SHPENZIME	4,671	4,671	40,473	40,663	26,770	5,335	32,105	13,893	66%
TOTALI I SHPENZIMEVE TE BASHKISE	18,391	4,671	40,473	69,285	44,940	5,335	50,275	24,345	65%

Siç shihet nga tabela e mësipërme realizimi I shpenzimeve operative vetëm për vitin 2014 është në masën 65 % dhe vlera prej 5,335 mijë lekë përbën detyrime të vitit 2014 të cilat do të mbarten në vitin 2015 dhe do të shlyhen në buxhetin e po këtij viti.


Më poshtë po japim të detajuar tabelën e realizimit të energjisë elektrike, ujit dhe telefonit për vitin 2014.

Realizimi I energjisë elektrike të Bashkisë është në masën 92% dhe jepet sipas tabelës së mëposhtme.

Nr		Fakt 2013	Pl 2014	Fakt 2014	Plan 14- Fakt 14	%
1	BASHKIA KORCE	1,076,989	1,276,800	1,229,253	47,547	96%
2	RAJONI NR. 1	65,360	78,120	59,597	18,523	76%
3	RAJONI NR. 3 (AGJENSIA)	49,493	64,680	51,843	12,837	80%
4	DREJTORIA TAT-TAKSA	222,390	262,080	230,587	31,493	88%
5	SHTEPJA RUMUNE	4,080	21,840	4,080	17,760	19%
6	ANTENA	4,072	23,520	4,258	19,262	18%
7	GARAZHET		5,880		#VALUE!	#VALUE!
8	BASHKIA (GJYKATA)	201,623	183,120	183,120	0	100%

9	RAJONI NR. 2	404,987	577,920	521,918	56,002	90%
	TOTALI	2,028,994	2,493,960	2,284,656	209,304	92%

Paraqitja grafike




Realizimi i konsumit të ujit është në masën 92%.

Nr.		Fakt 2013	Pl 2014	Fakt 2014	Plan 14-Fakt 14	%
1	Bashkia Korce (drejt e te ardh)	311,388	380,000	380,000	0	100%
2	Rajoni nr. 1	7,410	10,000	6,086	3,914	61%
3	Rajoni nr. 2 (zyrat)	19,506	50,000	50,000	0	100%
4	Rajoni nr. 3 agjensia ad	38,910	30,000	17,596	12,404	59%
5	Shtepia rumune	1,440	5,000	5,000	0	100%

6	Ish st. I lojrave me dorë		80,000	50,376	29,624	63%
	Total	378,654	555,000	509,058	45,942	92%

Paraqitja grafike



Realizimi i shpenzimeve telefonike ka qenë në masën 57%.

Nr.	Telefoni	Kujt i perket	Fakt 2013	PI 2014	Fakt 2014	Plan 14-Fakt 14	%
1	42004	Kryetari	151,347	150,000	54,840	95,160	37%
2	42082	Kryetari (fax)	19,200			0	#DIV/0!
3	42590	Drejtoria e Finances	75,241	72,000	50,897	21,103	71%
4	42951	Sekretari KB	33,099	50,000	22,634	27,366	45%
5	42966	Koordinim Zhvillimi	19,200			0	#DIV/0!
6	43032	Shef Kabineti	35,014	30,000	19,092	10,908	64%
7	43042	Personeli	20,628			0	#DIV/0!

8	43044	Zv/Kryetari	31,469	90,000	27,123	62,877	30%
9	43047	Gjendja Civile	20,451			0	#DIV/0!
10	43051	Numer I lire centrali	19,200			0	#DIV/0!
11	43055	Drejtoria e Auditimit	19,200			0	#DIV/0!
12	43061	Rajoni nr. 2	27,284	30,000	18,631	11,369	62%
13	43127	Rajoni nr. 3	28,780	35,000	18,799	16,201	54%
14	43212	Zv/Kryetari	65,115	110,000	78,783	31,217	72%
15	43249	Policia Bashkiake	24,474	30,000	18,881	11,119	63%
16	43353	Sekretare e Kryetarit	321,514	395,000	140,141	254,859	35%
17	43362	Rajoni nr. 1	32,526	35,000	23,931	11,069	68%
18	43382	Informacioni	19,200			0	#DIV/0!
19	44816	Drejtoria e Urbanistikes	19,200			0	#DIV/0!
20	44851	Drejtoria e Puneve Publike	24,241	30,000	18,403	11,597	61%
21	45755	Arkivi	25,807	60,000	19,575	40,425	33%
22	47631	Drejtoria e Personelit	45,899	55,000	29,125	25,875	53%
23	50277	Drejtoria e Perkra Sociale	38,622	65,000	27,355	37,645	42%
24	52802	Inspektoriati I Ndertimit	23,331	30,000	11,482	18,518	38%
25	51844	Drejtoria e te ardhurave	33,183	40,000	22,956	17,044	57%
26	42133	Mbrojtja nga dhuna	23,814	40,000	18,450	21,550	46%
27		Sherbime postare	213,726	370,000	358,698	11,302	97%
		Totali	1,410,765	1,717,000	979,796	737,204	57%

HUAMARRJA VENDORE (KREDIA)

Gjatë vitit 2014 ka vazhduar shlyerja e kështit të parë, të dytë dhe të tretë të kredisë. Kjo pagesë është bërë sipas kontratës së lidhur midis Bashkisë Korçë dhe **Pro Credit Bank** dhe planit të pagesave. Më poshtë po paraqesim të detajuar shlyerjen e kredisë.

- ✓ Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e parë të kredisë gjatë vitit 2010 është: princiali në vlerën 45.000.000 lekë dhe interesi në vlerën 21.625,908.13 lekë.

Për shlyerjen e këtij disbursimi është paguar për periudhën 2010-2014

vlera prej 11,014 mijë lekë (interesi) dhe princiali në vlerën 10,639 mijë lekë

- ✓ Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e dytë të kredisë gjatë vitit 2011 është: princiali në vlerën 23.800.000 lekë dhe interesi në vlerën 11.312.744.33 lekë.

Për shlyerjen e disbursimit të dytë është paguar për periudhën 2011-2014

vlera prej 4,919 mijë lekë (interesi) dhe princiali në vlerën 4,699 mijë lekë

- ✓ Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e tretë të kredisë gjatë vitit 2012 është: princiali në vlerën 23.800.000 lekë dhe interesi në vlerën 11.261.663.33 lekë.

Për shlyerjen e disbursimit të tretë është paguar për periudhën 2012-2014

vlera prej 2,399 mijë lekë (interesi) dhe principali në vlerën 1,983 mijë lekë.

Gjatë vitit 2014 me VKB është miratuar kredia në vlerën 200,000 mijë lekë, midis Bashkisë Korcë dhe **Intesa Sanpaolo Bank**, ku është nënshkruar dhe kontrata me nr 977rep/nr 928 Kol.datë 15.05.2014. Duke iu referuar kontratës dhe planin e pagesave po ju paraqesim dhe shlyerjen e kësaj kredie si më poshtë:

- ✓ Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e parë të kredisë gjatë muajit Tetor 2014 është: principali në vlerën 50.000.000 lekë dhe interesi në vlerën 16,606,549,31 lekë. Gjatë vitit të parë nuk do të kryhet pagesa e principalit, kurse pagesa e interesit fillon gjatë muajit shkurt 2015.
- ✓ Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e dytë të kredisë gjatë muajit Dhjetor 2014 është: principali në vlerën 100.000.000 lekë dhe interesi në vlerën 33,191,671.18 lekë. Gjatë vitit të parë nuk do të kryhet pagesa e principalit, kurse pagesa e interesit fillon gjatë muajit mars 2015.
- ✓ Disbursimi I tretë I kredisë do të kryhet gjatë muajit Mars 2015 në vlerën 50.000.000 lekë.

Në bazë të marrëveshjes së nën-huasë së nënshkruar midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bashkisë Korcë datë 13.02.2008 për projektin “Ndërtimi I Banesave me Qëllim Social”, shlyerja e kredisë e financuar nga CEB paraqitet si më poshtë:

- ✓ Transhi I parë 2014-2023 shuma e disbursuar është 340,214 euro
- ✓ Transhi I dytë 2016-2025 shuma e disbursuar është 640,000 euro
- ✓ Transhi I tretë 2017-2026 shuma e disbursuar është 110,000 euro
- ✓ Transhi I katër 2018-2027 shuma e disbursuar është 101,386 euro

Shuma e shërbimit të borxhit për transhin e parë të kredisë është: principali në vlerën 340,214 euro. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim në datën 18.12.2014 është paguar principali në vlerën 4,772,313 lekë (34,041.75 EURO *140.19)

Realizimi I kredisë për vitin 2014 jepet si më poshtë:

	PI 2014	Fakt 2014
SHLYERJA E KREDISE 2014	13,720	13,676
INTERESI	15,912	5,460
PAGESE PRINCIPALI	12,710	12,710

Transferta tek organizatat

Fondi i planifikuar për transfertat tek organizatat e ndryshme ka qenë në vlerën 10,750 mijë dhe gjatë vitit 2014 ky fond pësoi ndryshime dhe shkoi në vlerën 38,500 mijë lekë. Realizimi i transfertës tek organizatat e ndryshme për vitin 2014 ka qenë 21,206 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

- 5,042 mijë lekë transfertë për UKKO
- 400 mijë lekë transferta për KRWM
- 306 mijë lekë transferta për pagesën e projektit për fëmijët në nevojë
- 298 mijë lekë sipas projektit Qendër komunitare për të moshuarit
- 317 mijë lekë pagesa për komisionin për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël.
- 248 mijë lekë pagesë për shoqatën BID derdhje gabim për bashkinë.
- 12,002 mijë lekë kontributi financiar i Bashkisë për projektin e Inkubatorit të Biznesit.
- 2,149 mijë lekë transfertë nga të ardhurat e parkimit me pagese agentit tatimor Alben 2 Security.
- 444 mijë lekë transferta nga projektet e vitit 2013, qendra për të moshuarit.

Transferta tek individët

Fondi i planifikuar për transfertat tek individët ka qenë në vlerën 100 mijë lekë dhe gjatë vitit ky fond pësoi ndryshime dhe shkoi në vlerën 1,015 mijë lekë.

Realizimi për vitin 2014 ka qenë 975 mijë lekë si më poshtë:

- 154 mijë lekë transfertë tek individët për dalje në pension për 3 punonjës
- 90 mijë lekë transfertë tek individët për raste fatkeqësish
- 931 mijë lekë pagesë për paga për dy punonjës në listë pritjeje.

Planifikimi dhe realizimi i transfertave për vitin 2014 paraqiten dhe të detajuara sipas tabelës së mëposhtme:

	Det13	F14 det	PL2014	PI ND14	Fakt14	Det 2014	Fakt+Det 14	PL 14- Fakt 14	%
TRANSFERIMET	4,450	4,344	10,400	49,065	21,737	10,535	32,272	27,328	44%
TRANSFERTA TEK ORGANIZATAT	4,450	4,344	10,300	48,050	20,762	10,535	31,297	27,288	43%
Agjenti tatimor Aben 2 security				14,110	2,149	432	2,581	11,961	15%
TRANSFERTE PER UKK KORCE			4,000	5,050	5,042		5,042	8	100%
KONTR FINANC I BASHKISE PER PROJ NGA KE								0	#DIV/0!
KONTRIBUT I BASHKISE PER KRËM			3,000	3,000	400		400	2,600	13%
TRANSFERIME SIPAS PROJ FEMIJET NE NEVOJE			400	400	306	27	333	94	77%
TRANSFERTA PER PROJEKTET E VITIT	450	444					0	0	#DIV/0!
PROJ QENDRA KOMUNITARE PER TE MOSHUARIT			1,000	240			0	240	0%
MBESHTETJE PER PERSONAT E VETMUAR DHE MOSHUAR			400	400	298	33	331	102	75%
KONTRIBUT PER NDERTIMIN E QK PER INTEGRIM SOCIAL			1,500	1,500			0	1,500	0%
KOMISION PER TATIMIN E THJESHTUAR TE BIZNESIT TE VOGEL				1,000	317	43	360	683	32%
KORCA SHA 2008 PAGESA E DETYRIMEVE				100			0	100	0%
PROJEKTI I INKUBATORIT TE BIZNESIT				12,002	12,002		12,002	0	100%
Pagese per shoqaten BID derdhje gabim per bashkine				248	248		248	0	100%

Kontributi I qarkut	4,000	3,900		10,000	0	10,000	10,000	10,000	0%
Kontr fin I bash per pagesen e TVSH dhe kom bank								0	#DIV/0!
TRANSFERTA TEK INDIVIDET	0	0	100	1,015	975	0	975	40	96%
TRANSFERTA TEK INDIVIDET				915	885		885	30	97%
Transferta ne rast fatkeqesie			100	100	90		90	10	90%
TOTALI	4,450	4,344	10,400	49,065	21,737	10,535	32,272	27,328	44%

Sipas tabelës vlere prej 535 mijë lekësh, janë detyrime të vitit 2014, të cilat do të likujdohen gjatë vitit 2015.

Fondi i emergjencave civile

Fondi i planifikuar për emergjencat civile për vitin 2014 ka qenë në vlerën 500 mijë lekë. Ky fond u realizua në vlerën 240 mijë lekë, ndihmë financiare për familje të dëmtuara nga zjarri sipas VKB nr. 31 datë 03.4.2014.

Kontributi i qarkut

Fondi i planifikuar për kontributin e qarkut për vitin 2014 ishte 14,000 mijë lekë dhe realizimi ka qenë në vlerën 3,900 mijë lekë. Vlora prej 10,000 mijë lekë do të jetë detyrim i vitit 2014 dhe do të shlyhet gjatë vitit 2015.

Këshilltarët

Planifikimi për pagesën e këshilltarëve gjatë vitit 2014 ka qenë në vlerën 4,830 mijë lekë. Realizimi ka qenë në vlerën prej 4,824 mijë lekë.

SHERBIMET PUBLIKE

- Shërbimi I transportit qytetës** gjatë vitit 2014 u planifikua me një vlerë 6,500 mijë lekësh dhe jepet në formë subvencioni. Realizimi ka qenë në vlerën 6,398 mijë lekë. Ky shërbim mbështetet në realizimin e zërave të mëposhtëm :
 - Itenerari I përcaktuar në kontratë I mjeteve
 - Orari I shërbimit të këtij transporti
 - Numri I mjeteve në linjë
 - Fluksi I kalimit të autobusëve nëpër stacionet e përcaktuara
 - Qëndrimi i mjeteve nëpër stacionet e përcaktuara
- Shërbimi I mirëmbajtjes së varrezave publike dhe ato të dëshmorëve**
Fondi I planifikuar për vitin 2014 ka qenë 4,431 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 3,800 mijë lekë ose në masën 85.7%. Ky shërbim konsiston në zërat e mëposhtëm :

- a. Pastrim parcelash, rrugë dhe sheshe të brendshme ndërmjet blloqeve të varrimit
- b. Mirëmbajtje drurë dhe shkurre dekorative
- c. Mbjellje drurë dekorative
- d. Mirëmbajtje dhe krijim gardhe të gjelbërt me ligustër dhe lavandinë
- e. Kositje, grumbullim dhe transport bari
- f. Mirëmbajtje bordure betoni të brendshme
- g. Lyerje me gëlqere të bordurave dhe pemëve në varrezat publike dhe të dëshmorëve
- h. Ruajtja e objektit në varrezat publike dhe të dëshmorëve
- i. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve
- j. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve nga amortizimi
- k. Mirëmbajtje e murit rrethues
- l. Konsumi i ujit të pijshëm për mirëmbajtje dhe nevojat e qytetarëve

3. **Shërbimi i pastrimit të qytetit** gjatë vitit 2014 ky shërbim është një nga shërbimet më të rëndësishme që kryen Bashkia në shërbim të komunitetit. Fondi i planifikuar për vitin 2014 ka qenë 105,766 mijë lekë nga të cilat 46,864 mijë lekë ishin detyrim i vitit 2013 dhe 58,902 mijë lekë fondi i planifikuar në vitin 2014, kurse realizimi ka qenë në vlerën 51,299 mijë lekë. Vlera prej 50,427 mijë lekë përbën detyrim të vitit 2014 e cila do të shlyhet gjatë vitit 2015. Realizimi ka qenë në masën 48.5%.

Objekti i këtij shërbimi është:

- pastrimi i rrugëve dhe trotuareve,
- evadimi i mbetjeve urbane në qytetin e Korçës dhe përpunimi i tyre,
- lagia e rrugëve,
- evadimi i dëborës në stinën e dimrit dhe hedhja e kripës për lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe njerëzve, etj.

Pastrimi i rrugëve bëhet çdo ditë prej orës 24.00 deri 06.00. Pastrohen çdo ditë 429861 m² rrugë dhe trotuare. Transporti i mbeturinave për në fushën e grumbullimit dhe përpunimit të tyre bëhet çdo ditë me mjete teknologjike prej orës 03.00 deri 07.00 për evadimin e mbetjeve nëpër konteniere dhe prej orës 07.00 deri 11.00 për lagjet që nuk kanë konteniere. Çdo ditë evadohen rreth 80 ton mbeturina. Lagia e rrugëve bëhet për periudhën 01.04 deri 31.10 çdo ditë nga ora 06.00 deri 18.00 në një sipërfaqe prej 295,870 m² si dhe larje speciale e rrugëve me sipërfaqe 70,236 m² çdo ditë. Grumbullimi i mbeturinave bëhet me rreth 400 konteniere.

Gjithashtu në këtë shërbim hyn edhe pagesa për supervizorin e pastrimit. Fondi i planifikuar për shpenzime për paga për vitin 2014 ka qenë 521 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 508 mijë lekë ose 97.5%.

Fondi i planifikuar dhe realizuar për shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2014 ka qenë 85 mijë lekë.

SPONSORIZIME

Gjatë vitit 2014 Bashkia Korçë ka pasur financime projektsh nga Bashkimi European. Menaxhimi i fondeve të këtyre projekteve do të kryhet në bankat e nivelit të dytë. Për këtë arsye u krye transferimi i këtyre fondeve nga Dega e Thesarit tek bankat e nivelit të dytë. Financimi i këtyre projekteve paraqitet i detajuar si më poshtë:

- 1- Projekti “Diferencimi i Produktit Turistik: Shtigjet Eko-Turizëm në zonën ndërkufitare për promovimin e Turizmit alternativ”, në vlerën 7,913 mijë lek
- 2- Projekti “Zhvillimi i një produkti turistik të integruar për rritjen e qëndrueshme ekonomike të rajoneve të Gostivarit dhe Korcës”, në vlerën 13,243 mijë lek
- 3- Projekti “ Krijimi i Inkubatorëve të Teatrit dhe Grave - ËATCH”, me vlerë 3,330 mijë lek.

Gjatë vitit 2014 është trashëguar dhe një fond me vlerë 38 mijë lek i cili është përdorur për shpenzime te ndryshme operative me vlerë 37 mijë lek.

ANALIZA E PROJEKTEVE 2014**Karta për pensionistët****Përshkrim shkurtimisht:**

Bashkia Korçë, realizoi edhe këtë viti projektin “Karta për pensionistët”. Ky projekt ofron për të gjithë pensionistët shërbim falas në transportin urban, shërbime e analiza mjekësore falas në disa klinika në qytet, ulje të çmimit të biletës në teatër si edhe në disa shërbime të tjera të nevojshme për moshën e tretë.

Pasi u përcaktua një dizajn i kartës, biznesi i cili fitoi tenderin për këtë projekt, realizoi printimin e kartave të pensionistëve.

Vlera totale e këtij projekti nga Bashkia: **250 000 Lek**

Vlera e realizuar e projektit: **33 464 Lek.**

Festa e Birrës 2014

www.festaebirres.com

Përshkrim shkurtimisht:

Projekti “Festa e Birrës” i implementuar për të tetin vit radhazi synoi stimulimin, mbështetjen, promovimin e bizneseve lokale, zhvillimin e turizmit nëpërmjet kthimit të kësaj feste në traditë si dhe gjallërimin e jetës në qytet. Këtë vit festa e birrës, pati një sërë aktiviteteve të zhvilluara përgjatë 5 netëve 13-17 gusht 2014 jo vetëm në Parkun Rinia të qytetit, por edhe gjatë orëve të paradites në Zonën Pedonale të qytetit, ku të gjithë turistët vendas dhe të huaj mund të shijonin ofertat e birrës nga biznese të ndodhura në këtë zone.

Gjatë pesë netëve të festës, u vu re një audience masive, jo vetëm nga qyteti i Korçës dhe rrethinat e tij, por edhe turistët vendas dhe të huaj, të ardhur posaçërisht për të ndjekur këtë event të rëndësishëm. Risi e festës së birrës për këtë vit ishte shtrirja e kësaj feste në të gjithë qytetin, duke e kthyer qytetin e Korçës në një zonë birre.

Festa e Birrës u mbështet kryesisht nga bizneset lokale si dhe donatorë të ndryshëm. Ky event përveç se përfaqëson një nga eksperiencat më pozitive dhe më të suksesshme të zhvillimit të turizmit, promovon gjithashtu qytetin dhe ato çka ai përfaqëson si një destinacion të rëndësishëm turistik në Shqipëri.

Vlera totale e këtij projekti nga Bashkia: **1 000 000 Lek**

Vlera e realizuar: **984 800 Lek**



Foto nga Festa e Birrës 2014

Panairi i fundvitit

Përshkrimi shkurtimisht:

Festimi i festave të fundvitit në Korçë është një nga eventet më të rëndësishme për qytetin. Të qënit kryesisht një komunitet që i do festat, dekorimi i qytetit si asnjëherë tjetër, si dhe eventet e ndryshme që shoqëruan këtë periudhë, bëri që festat e fundvitit të kthejnë Korçën në qendrën turistike të Shqipërisë të festave të fundvitit.

Këtë vit, për të krijuar një ambient ndryshe nga çdo vit më parë si dhe për të përçarur kudo mesazhin se festat e fundvitit festohen më bukur se kudo në Korçë, u dekorua Shtëpia Rumune. Qendra e Artit dhe e Kulturës e e dekoruar dhe e shndërruar në "Shtëpinë e babagjyshit", qëndroi e hapur për gati dy jave që nga data 22 dhjetor deri në 31 dhjetor dhe mirëpriti të gjithë fëmijët për t'u takuar me babagjyshin dhe për të bërë një foto me të. Në zonën këmbësorë u zhvillua Panairi dimëror i Librit dhe panairi me pije tradicionale dhe me artikuj të ndryshëm që lidhen me festat.

Shumë vizitorë vendas dhe të huaj preferuan Korçën si destinacion të pushimeve dimërore.

Panairi së bashku me aktivitetet e organizuara si Koncertet apo aktivitetet për fëmijë, si "Parada e Babagjyshit", pista e përhershme e patinazhtit etj, tërhoqën vëmendjen e qytetarëve dhe vizitorëve që vizituan Korçën, në këtë periudhë.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **600 000 Lek**

Vlera e realizuar e projektit: **556 424 Lek**

130 000 honorare

382 824 dekor

18 600 fishekzjarre

25 000 qera llandoni

**Dekori në Zonën Pedonale****Parada e Babagjyshit****Pista e Patinazhit****Panairi Dimeror i Librit****Festivali i Ushqimit****Projekti i realizuar: Festa e Lakrorit****Përshkrim shkurtimisht:**

Projekti “Festa e Lakrorit 2014” u implementua edhe këtë vit në formën e një eventi që tërhoqi vëmendjen dhe pjesëmarrjen e shumë vizitorëve, duke konsoliduar profilin festiv të kësaj tradite dhe qytetit të Korçës. Kjo festë tashmë e kthyer në një festë të përvitshme, thekson dhe njëherë mesazhin se Korça është qyteti që ruan dhe zhvillon traditat e saj më të mira duke i kthyer ato në potenciale turistike.

Festa u zhvillua në mjediset e gjelbëruara të lulishtes “Vangjush Mio”, ku gatimi tradicional, lakrori i prodhuar në çast nga amvisat korçare ju servirej qytetarëve. Realizimi i pjesës teknike të infrastrukturës së eventit u bë në bashkëpunim me biznesin privat, i cili u kontraktua për marrjen me qera të pajisjeve të nevojshme, stola, tavolina, tenda saçe etj.

Ky event u shoqërua me muzikë live, duke sjellë kështu një pasdite ndryshe në qytet.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **100 000 Lek**

Vlera e realizuar e projektit: **99 600 Lek.**



“Respekt për mësuesit”

Përshkrim shkurtimisht:

Me rastin e 7-Marsit, festës së mësuesve, Bashkia Korçë zhvilloi në ambientet e hotel “Life Gallery” një pritje koktej me mësues korçarë, të cilët kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në edukimin e brezave.

Në pritjen e nderit, Kryetari i Bashkisë përcolli urimet dhe falenderimet për kontributin e jashtëzakonshëm të mësuesve korçarë në vite, të cilët punuan gjithë jetën në këtë profesion kaq të dashur duke edukuar me profesionalizëm, përkushtim dhe fisnikëri disa gjenerata.

Gjithashtu në kuadër të këtij aktiviteti u zhvillua edhe një konkurs mes shkollave 9-vjeçare të qytetit të Korçës për esenë më të mirë. Nxënësi fitues u vlerësua në ditën e 7 Marsit me një certifikatë për çmimin “Esseja më e mirë”.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **100 000 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **80 000 Lek.**



“Panairi i Pranverës”

Përshkrim shkurtimisht:

Në çelje të sezonit Pranveror, Bashkia Korçë organizoi edhe këtë vit "Panairin e Pranverës", i cili u shoqërua nga një sërë aktivitete të ndryshme artistike e kulturore.

Në sheshin para Katedrales u zhvillua edhe panairi i poçerisë, në të cilin morën pjesë artizanë, të cilët promovuan punimet e tyre.

Aktivitetet e shumëllojshme të zhvilluara në këtë periudhë përfshinin panair në Zonën Pedonale, aktivitete për fëmijë, koncerte, ekspozita fotografike, ekspozita pikturë dhe filluan në mes të Prillit (15 Prill) dhe vazhduan deri në javën e parë të Majit, sipas një kalendari aktivitete etj.

Rëndësi iu dha edhe dekorit në këtë periudhë. Zona Këmbësore, qendra kulturore “V.Mio” si edhe sheshi para katedrales së qytetit u dekoruan në mënyrë të veçantë. Të gjitha pemët e zonës pedonale u dekoruan me lule për të krijuar atmosferë pranverore.

Ky aktivitet krijoi një atmosferë pranverore në qytet si edhe një mënyrë argëtuese për të gjithë fëmijët, të cilët u argëtuuan në këndin e realizuar posaçërisht për ta.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **40 000 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **39 960 Lek**



Kalendari i Aktiviteteve 2014

Përshkrim shkurtimisht:

Bashkia Korçë, me qëllim promovimin e aktiviteteve social- kulturore e turistike të qytetit, promovimin e muzeumeve dhe atraksioneve turistike të rajonit si edhe për të pasur një paketë informuese për vizitorët vendas dhe të huaj që vizitojnë qytetin, realizoi Kalendarin e Aktiviteteve 2014, i cili përmbledh paketën e plotë të eventeve të rajonit të Korçës.

Pas konfirmimit të datave të sakta të aktiviteteve, u konceptua draft kalendari, i cili përfshinte përshkrimet e aktiviteteve, datat përkatëse si edhe foto të aktiviteteve. Pas konfirmimit të draftit final për këtë projekt, u realizua printimi i kalendarit nga kompania fituese e tenderit.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **100 000 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **44 400 Lek**



Bursa për gjimnazistët

Përshkrim shkurtimisht:

Bashkia e Korçës vazhdon të zbatojë çdo vit projektin “Bursa për gjimnazistët”, i cili synon stimulimin e nxënësve dhe nxitjen e tyre për të arritur rezultate të shkëlqyera.

Duke qënë një program social-arsimor, përfitues janë nxënësit me të gjitha notat 10 për vitet e njëmbëdhjeta, të dymbëdhjeta në të gjitha shkollat e mesme publike dhe jopublike të qytetit të Korçës.

Projekti “Bursa për gjimnazistët” ka si synim jo vetëm vlerësimin moral, por edhe material të gjimnazistëve me të gjitha notat dhjeta, në formën e një burse mujore, e cila shërben si një formë e re nxitjeje për nxënësit me qëllim arritjen e rezultateve me të larta, duke e kthyer arsimimin në një prioritet të tyre.

Drejtoria Rajonale e Arsimit u përfshi në dhënien e emrave të nxënësve të shkëlqyer të vitit akademik 2013-2014, të cilët janë përfitues direktë të projektit.

Në datën 6 Dhjetor 2014 në ambientet e Shtëpisë Rumune u organizua ceremonia e shpërndarjes së certifikatave për 46 nxënësit me të gjitha notat dhjeta nga pesë gjimnazet publike dhe jopublike të qytetit.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **1 000 000 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **311 760 Lek**



Foto nga Ceremonia e shpërndarjes së certifikatave për gjimnazistët e shkëlqyer

Konferencë për PPP (Pjesëmarrje në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit)

Përshkrim shkurtimisht:

Projekti “Konferencë për PPP”, nuk u realizua pasi lidhur me këtë projekt, është duke u mbledhur informacioni i nevojshëm për asetet e bashkisë. Gjithashtu projekti është paraqitur në donatorë të ndryshëm për të siguruar mbështetje financiare, për realizimin e konferencës.

Për të realizuar pjesëmarrjen në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit u bë ndryshimi i zërit të shpenzimeve nga projekti “**Konferencë për PPP**” në zërin: Shërbime të printimit dhe publikimit në vlerën 167.532 lekë për projektin “**Pjesëmarrje në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit**”, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i projektit	Ishte	Pakësohet (-)	Shtohet (+)	Bëhet
1.	Konferencë për PPP	200.000	167.532	-	32.468
2.	Pjesëmarrje në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit	0	-	167.532	167.532

	Totali	200.000	167.532	167.532	200.000
--	---------------	----------------	----------------	----------------	----------------

Panairin Ndërkombëtar i Turizmit, u zhvillua në ambientet e Pallatit të Kongreseve në Tiranë, prej datës 22- 26 Nëntor 2014. Bashkia Korçë u prezantua në panair në stendën 12 m² (4m x 3m) , në të cilën u promovua qyteti i Korçës.

Qëllimi i pjesëmarrjes së Bashkisë së Korçës në këtë panair është promovimi i vlerave kulturore, prezantimi i eventeve turistike të rajonit, të cilat ndikojnë në zhvillimin rajonal si edhe është një mundësi e vlefshme për te promovuar politikat dhe strategjitë e ndërmarra nga pushteti lokal të cilat ndikojnë në zhvillimin rajonal. Panairi konsiderohet si një mundësi reciproke për të shmangur edhe ngarkesat lokale apo nacionale duke i dhënë përparësi biznesit, kooperimit nëpërmjet filozofisë të një harte rajonale ku të gjitha palët shikojnë mundësi, interesa për promovime dhe përfitime reciproke.

Vlera totale e projektit “Pjesëmarrje në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit”: **200 000**

Lek.

Vlera e realizuar: **167. 532 Lek.**



Foto e stendës Bashkia Korçë

Festa e 1 Qershorit

Përshkrim shkurtimisht:

Bashkia Korçë, me rastin e festës së fëmijëve organizoi edhe këtë vit një sërë aktiviteteve social-kulturore.

Në datën 31 Maj nga përfaqësues të Bashkisë Korçë u ndanë dhurata për fëmijët e kopshtit të lagjes së Francezëve. Festa e 1 Qershorit u realizua në ambientet e parkut “Rinia”, ku u zhvillua një koncert festiv, organizuar nga Qendra Kulturore e Fëmijëve “Mihal Grameno”, ekspozita pikturë dhe këndi i vizatimit për fëmijët.

Të gjithë fëmijët e qytetit të shoqëruar nga prindërit festuan Festën e 1 Qershorit në atmosferën festive të krijuar enkas për ta. Qendra Kulturore e Fëmijëve “Mihal Grameno” ne bashkepunim me grupet e baletit te qytetit organizuan per te gjithë femijet e pranishem ne festë nje koncert festiv. Gjithashtu ne ambientet e festes u organizuan edhe ekspozita me vizatime nga femijet e kopshteve te qytetit.

Festa vazhdoi gjatë orëve të pasdites në Zonën Këmbësore të qytetit, ku u zhvilluan lojëra të ndryshme për fëmijët nga Fondacioni Kenedi dhe grupe animatorësh, të shoqëruara me muzikë.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **61 200 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **50 289 Lek.**



Dita Ndërkombëtare e PAK

Përshkrim shkurtimisht:

Me anë të këtij projekti, Bashkia Korçë ka si synim sensibilizim të popullsisë në lidhje me gjithëpërfshirjen e PAK në jetën e përditshme.

Tek Pallati i Kulturës u organizua një aktivitet kulturor me temë “Festojmë së bashku”, ku morën pjesë PAK të të gjitha qendrave të Aftësisë së Kufizuar të qytetit si dhe u zhvillua një koncert artistik nga fëmijët e Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Mihal Grameno” dhe grupe të ndryshme valltarësh. Koncerti u përmbyll me një koktej për të gjithë të ftuarit në aktivitet.

Gjithashtu tek Biblioteka e qytetit u zhvillua një takim i zgjeruar i të gjitha institucioneve shtetërore dhe private të qytetit si dhe i të gjitha OJF-ve që kanë si fokus Aftësinë e Kufizuar me tematikë: “Shmangia e barrierave që dalin para PAK dhe arritjen e gjithëpërfshirjes së tyre në jetën sociale të qytetit.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **60 000 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **60 000 Lek.**



Aktiviteti i Dites Nderkombetare te PAK date 3 Dhjetor 2014 ne ambientet e bibliotekes "Thimi Mitko", Korçe



Aktiviteti i Ditës Ndërkombëtare te PAK datë 3 Dhjetor 2014 në ambientet e Qendrës së Artit dhe Kulturës, Korçë

Dita e të Drejtave të Fëmijëve

Përshkrim shkurtimisht:

Nëpërmjet projektit të 20 Nëntorit "Ditës së të Drejtave të Fëmijëve", të gjithë fëmijët e shkollave 9-vjeçare të qytetit u njohën më mirë, me të drejtat dhe detyrat që ata kanë. Senatorët dhe Qeveritë e nxënësve të të gjithë shkollave 9-vjeçare të qytetit zhvilluan një takim me Kryetarin e Bashkisë, ku u shkëmbyen mendime te ndryshme në lidhje me të drejtat dhe detyrat e tyre .

Përmes aktiviteteve të ndryshme sensibilizuese u dha mesazhi për t' i thënë stop punës së të miturve .

Po kështu ata u argëtuan nëpërmjet aktiviteteve sportive dhe argetuese, si edhe lojrave argëtuese nga Fondacioni “Kenedi”.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **71 500 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **70 200 Lek.**



Dita e Jetimëve

Përshkrim shkurtimisht:

Bashkia Korçë, duke marrë parasysh nevojat e fëmijëve të Shtëpisë së Foshnjës për bebelina dhe batanije, vendosi që me fondin që ishte në dispozicion për projektin “Dita e Jetimëve” të miratuar në buxhet, të plotësonte sadopak nevojat e tyre.

Në bashkëpunim me Drejtorinë Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, u shpërndanë 20 batanije për fëmijët. Aktiviteti përfundimtar u realizua në datën 20 Maj 2014, Ditën Ndërkombëtare të Jetimëve, ku Kryetari i Bashkisë iu shpërndau fëmijëve të Shtëpisë së Foshnjës dhurata, duke treguar gadishmërinë për mbështetje të vazhdueshme ndaj këtyre fëmijëve.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **64 000 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **35 760 Lek.**



Korça City Map

Përshkrim shkurtimisht:

Vlera prej 20 000 Lekë e parashikuar në buxhet për realizimin dhe publikimin e hartës turistike

“Korça City map” nuk u shpenzua pasi projekti u realizua me fonde të mbledhura nga biznese lokale në qytet, të cilat u promovuan në hartë.

Vlera totale e projektit: **20 000 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **0 Lek.**



Panairi i Punës dhe Punësimi Sezonal

Përshkrim shkurtimisht:

Vlera totale prej 60 000 Lekë e parashikuar në buxhet për realizimin e Panairit të Punës dhe Punësimit Sezonal nuk u shpenzua pasi të dy projektet u realizuan me mbështetjen financiare të donatorëve.

Punësimi Sezonal u realizua në bashkëpunim me Zyrën e Punës, ku 20 studentët e përzgjedhur për të qenë pjesë e Punësimit Sezonal pranë Bashkisë Korçë, kryen praktikën profesionale për një periudhë 3 mujore në drejtori të ndryshme pranë Bashkisë.

Vlera totale e projektit: **60 000 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **0 Lek.**





*Foto nga Panairi i Punës Foto nga takimi për projektin
“Punësimi Sezonal”*

KITE SHKOLLORE PËR FËMIJËT NË NEVOJË 2014

Përshkrim shkurtimisht:

Për të qëndruar sa më afër fëmijëve të familjeve në nevojë, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, pranë Bashkisë Korçë, studioi problematikën e fillimit të vitit të ri akademik 2014-2015. Vlerësimi i nevojave për këtë vit shkollor nxorri prioritet pajisjen me libra të fëmijëve të këtyre familjeve. Në kuadër të programit të qytetit social, Bashkia Korçë ka planifikuar sërish, edhe këtë vit, vazhdimësinë e këtij projekti duke rezervuar një fond të caktuar për blerjen dhe shpërndarjen e librave skollorë falas, fëmijëve të shtresave vulnerabël. Qëllimi i këtij projekti është minimizimi i nivelit të braktisjes së shkollës dhe rritja e aksesit të fëmijëve në arsim si një nga të drejtat themelore të tyre. Nga ky projekt përfitojnë 51 fëmijë, nga familje në nevojë ku një pjesë e madhe e përfituesve janë fëmijë jetimë, fëmijë nga komunitetet e marxhinlizuara si rom dhe egjiptian, fëmijë nga familje në nevojë me kushte të vështira social-ekonomike.

QËLLIMI

Minimizimi i nivelit të braktisjes shkollore dhe rritja e aksesit të fëmijëve në arsim si realizim i të drejtave fëmijëve.

Vlera totale e këtij projekti nga Bashkia: **100.000 Lek**

KAMPI VEROR 2014

Përshkrim shkurtimisht:

Si çdo vit me ngrohjen e kohës, fëmijët dhe prindërit fillojnë të mendojnë për verën, pushimet shkollore, ndryshimin e rutinës së jetës të përditshme, dhe pse jo, mundësinë e marrjes pjesë në një Kamp Veror. Në kuadër të programit për një qytet social dhe gjithëpërfshirës, BASHKIA KORÇË edhe këtë vit organizoi kampin veror me fokus fëmijet

nga shtresat vulnerabël të qytetit. Në kamp morën pjesë 100 fëmijë dhe kampi zgjati gjatë gjithë muajit Korrik. Qëllimi i këtij kampi veror është të krijojë hapësira të sigurta për fëmijët ku ata të kenë mundësi të edukohen, të argëtohen, të ndërtojnë marrëdhënie të reja me njëri-tjetrin në funksion të gjithëpërfshirjes dhe të të drejtës për pjesëmarrje aktive. Synimi i Bashkisë Korçë është që të vazhdojë dhe në vitet e ardhshme organizimin e kampeve, duke qenë se është hedhur tashmë një themel shumë i mirë në drejtim. Ky është viti i shtatë që Bashkia Korçë organizon kampin dhe është vënë re që është një mundësi shumë e mirë për fëmijët.

Bashkëpunimi me donatorë të tjerë dhe organizata që kanë në fokus ose në mission fëmijët më në nevojë ka qenë shumë pozitiv dhe kemi besimin se ky bashkëpunim jo vetëm që do të vazhdojë por do të thellohet më shumë. Fakti që këtë vit na është bashkuar dhe World Vision në organizimin e kampit veror, është një shenjë që Bashkia Korçë e synon qëndrueshmërinë dhe është gati të kontrobuojë me kontribute të llojeve të ndryshme për ta arritur këtë. Për këtë arsye do të synohet që këtë vit fokusi të jetë në ngritjen e kapaciteteve të adulateve të përfshirë në kamp si një nga mënyrat që kontribuon të qëndrueshmëria.

Vlera totale e këtij projekti nga Bashkia: **803.000 Lek**





Mbështetje për personat e moshuar dhe të vetmuar

Qendër Komunitare për moshën e tretë

Përshkrim shkurtimisht:

Aktivitetet sociale të organizuara si brenda edhe jashtë ambienteve të qendrave kanë qenë impesive si për stafin e projektit ashtu edhe për vetë përfituesit. Numri i përfituesve në të dy qendrat ditore ka ardhur në rritje 130-140 përfitues nga 100 të planifikuar. Në muajin qershor Fondacioni Misioni Emanuel mori përsipër rmenaxhimin e dy qendrave të tjera ditore.

Hapja e këtyre dy qendrave u finalizua në muajin shtator 2014.

Kjo solli edhe rritjen e numrit të përfituesve në 250 të moshuar, deri në fund të vitit 2014.

Disa aktivitete të zhvilluara në këto qendra ditore për moshën e tretë kanë qenë:

- Shërbimet ditore. Ky aktivitet ka qenë në vazhdimësi për gjithë vitin dhe konsistonte në shërbime ditore me kafe, çaj, pije të ndryshme, biskota, kek, gazetë, lojrat e ndryshme etj. Numri i të moshuarve që kanë përfituar nga këto shërbime ditore ka shkuar në 280 – 300 përfitues.
- Organizimi çdo muaj i festave të ditëlindjeve për të gjithë të moshuarit. Ata janë ndjerë të lumtur dhe të kënaqur të festojnë së bashku këto ditë të veçanta, nën një atmosferë të ngrohtë dhe të gëzuar, përgatitur nga stafi i projektit . Çdo i moshuar që ka pasur ditëlindjen ka marrë një dhuratë të vogël simbolike. Ditëlindjet janë festuar në ambientet e vetë qendrave.
- Një herë në muaj, punonjësit sociale të qendrave kanë organizuar ditën e orës sociale me të moshuarit duke trajtuar tema të ndryshme sociale. Vetë të moshuarit kanë qenë pjesë e diskutimit gjatë zhvillimit të këtyre bisedave. Gjithashtu, çdo ditë, të moshuarve iu është dhënë mundësia të konsultohen me punonjësin social për probleme sociale dhe psikologjike që ata kanë pasur.

- Të moshuarit kanë marrë edhe një përkujdesje shëndetsore. Herë pas here është bërë kontrolli i tensionit të gjakut. Këtë vit u realizua edhe kontrolli i analizave të gjakut nga stafi i “Qendrës së Kujdesit Paliativ” Mary Potter Korçë.
- Në ambientet e vetë qendrave janë organizuar edhe festimi i festave Kombëtare si: Dita Ndërkombetare e Gruas, 8-te Marsi; Dita e të Moshuarve - 1 Tetor, festimi i 28-29 Nëntorit, festimi i Pashkëve dhe Krishlindjes, etj.
- Në dt 24 dhe 27 qershor stafi i projektit ka organizuar një ekskursion me përfituesit e dy qendrave. Të moshuarit kanë marrë pjesë me shumë dëshirë dhe kënaqësi. Ekskursioni u organizua në malin e Moravës, në ambientet e bukura dhe çlodhëse të lokalit Vila Mema. Të moshuarit shijuan ushqimin e shijshëm nën tingujt e bukur të muzikës tradicionale Korçare. Shumë mirënjohje dhe falenderime u përcollën nga të gjithë pjesëmarrësit për donatorët dhe organizatorët e ekskursionit.
- Një aktivitet social i cili ndiqet me shumë dëshirë nga të moshuarit, dhe me një pjesëmarrje të konsiderueshme nga burrat është edhe konkursi i lojës së dominosë. Fituesi i kësaj loje ka marrë edhe një shpërblim simbolik. Ky konkurs u zhvillua një herë në muajin maj’2014 dhe një herë në muajin tetor’2014. Në muajin tetor u organizua në të katër qendrat ditore.
- Nga gratë të cilat frekuentojnë qendrat është treguar një interes i veçantë edhe për punimet artizanale. Punime shumë të bukura janë ekspozuar në një ambient të veçantë të këtyre qendrave.

Vlera totale e projektit “Mbështetje për personat e moshuar dhe të vetmuar”: 400 000

Lek.

Vlera totale e projektit “Qendër komunitare për moshën e tretë” : 1 000 000 **Lek.**



Qendra Komunitare për fëmijët në nevojë
Përshkrim shkurtimisht:

Në kuadër të projektit “Fuqizimi i fëmijëve Romë dhe Egjiptianë”, gjatë vitit 2014, Fondacioni “Misioni Emanuel” ka organizuar takime dhe trajnime me përfituesit direkt apo indirekt të projektit, si edhe takime me përfaqësues qeveritarë apo joqeveritarë.

Çdo muaj janë organizuar takime me komitetin e prindërve. Komiteti është përfshirë në vendime të rëndësishme duke filluar që nga zgjedhja e ushqimit në qendër; nevojat e fëmijëve për libra, mjete shkollore, rroba etj ; procesi i të mësuarit në qendër; disiplina dhe marrja e masave në rast nevojë; diskutimet në lidhje me kampet verore etj

Me fëmijët e dy qendrave janë organizuar takime të veçanta mbi vlerat e ushqimit dhe çështjet e higjienës. Këto takime janë zhvilluar një herë në muaj.

Të përmuajshme kanë qenë edhe trajnimet me nënat mbi përkujdesjen e fëmijëve. Trajnimet janë zhvilluar nga një mjeke pediatre dhe trajtonin tema nga më të ndryshmet, si: sëmundjet infektive si pasojë e kequshqyerjes, sëmundjet bakteriale që prekin fëmijët kryesisht në stinën e verës, i ftohti, simptomat dhe shkaqet e tij, hepatiti viral etj

Gjatë muajit Qershor dhe Korrik fëmijët e të dy qendrave kanë qenë pjesë e kampeve verore. 16 fëmijë ishin pjesë e kampit “Udhëkryq” në Ersekë. Të shoqëruar nga vullnetarët fëmijët kaluan një javë të paharrueshme në këtë kamp.

Takime të tjera kanë qenë ato të zhvilluara me përfaqësues të ministrisë. Synimi kryesor i këtyre takimeve është për të lobuar për të pasur sa më shumë shërbime për përfituesit e projektit.

Kështu gjatë vitit 2014 janë zhvilluar dy takime me përfaqësues të NGO-ve të ndryshme, takime me përfaqësues të Bashkisë Korçë dhe Shërbimin Social. Një takim me rëndësi ishte ai i zhvilluar në Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, në Shtator 2014, ku u bë një prezantim i përgjithshëm i fondacionit dhe projekteve të tij.

Në muajin Nëntor në kuadër të takimit me Komitetin e Prindërve, u zhvillua një aktivitet më i gjerë me rastin e ditës ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve.

Në muajin Dhjetor, fëmijët e secilës qendër organizuan aktivitete me rastin e Krishtlindjes dhe Vitit të Ri.

Vlera totale e projektit: 400 000 **Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: 333 000 **Lek**





Artistët e Vegjël

Përshkrim shkurtimisht:

Në kuadër të programit “Qyteti për fëmijët”, u realizua edhe këtë vit projekti “Artistët e vegjël”.

Projekti ka si qëllim socializimin e fëmijëve përmes zhvillimit të kurseve të ndryshme, për kitarë, vizatim, aktrim, kanto, balet dhe fashion-design për fëmijë të grupmoshes nga 8-13 vjeç, të cilët kanë mundësi të evidentojnë dhe perfeksionojnë talentin e tyre.

Pas rikonstruksionit, ambientet e bibliotekës të fëmijëve “Thoma Turtulli”, u kthyen në një qendër, e cila u vu në dispozicion të fëmijëve çdo pasdite dhe me përfundimin e vitit shkollor qendra do të jetë në dispozicion gjatë gjithë ditës për të ofruar sa më shumë mundësi studimi dhe argëtimi. Në dispozicion të nxënësve u vunë edhe dy salla studimi të pajisura me libra të ndryshëm, ku nxënësit kishin mundësi të lexonin apo të kryenin detyra të ndryshme.

Në këto kurse u regjistruan rreth 90 fëmijë, të cilët frekuentonin dy herë në javë kurset, të shpërndarë sipas grupeve në të cilat bënë pjesë.

Vlera totale e projektit: **300 000 Lek** - 180 000 honorare
- 30 000 publikime
- 90 000 materiale



INVESTIMET 2014

Burimet kryesore të realizimit të investimeve të Bashkisë në vitin 2014, kanë qënë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore , transfertat e pakushtëzuar , të ardhurat e trashëguara të vitit 2013 , huamarrja vendore (kredia), si dhe fondi i zhvillimit të rajoneve (financime nga buxheti i shtetit).

Investimet e Bashkisë për vitin 2014 janë planifikuar në vlerën 898,503 mijë lekë dhe janë realizur në vlerën 604,696 mijë lek ose në masën 67.3% .

Sipas programeve planifikimi dhe realizimi paraqitet si më poshtë:

- infrastruktura rrugore nga të ardhurat e Bashkisë, planifikimi ka qënë 62,703 mijë lekë dhe realizimi 33,034 mijë lekë
- administrim i përgjithshëm (blerje paisje), planifikimi ka qënë 4,343 mijë lekë dhe realizimi 2,940 mijë lekë
- shërbime publike, planifikimi ka qënë 22,130 mijë lekë dhe realizimi 5,129 mijë lekë
- studime urbanistike, planifikimi ka qënë 6,590 mijë lekë dhe realizimi 5,411 mijë lekë
- investime në arsim, planifikimi ka qënë 1,365 mijë lekë

- investime në kulturë, planifikimi ka qënë 13,666 mijë lekë dhe realizimi 286 mijë lekë
- infrastruktura rrugore nga huamarrja vendore (kredia), planifikimi ka qënë 70,000 mijë lekë dhe realizimi 22,307 mijë lekë
- shërbime publike nga huamarrja vendore (kredia), planifikimi ka qënë 130,000 mijë lekë
- infrastruktura rrugore nga fondi i Zhvillimit të Rajoneve, planifikimi ka qënë 587,706 mijë lekë dhe realizimi 535,589 mijë lekë

Realizimi i investimeve sipas programeve jepet i detajuar si më poshtë:

Infrastruktura rrugore

Gjatë vitit ky fond i planifikuar për programin e infrastrukturës rrugore nga të ardhurat e bashkisë ka qënë në vlerën 62,703 mijë lekë dhe realizimi ka qënë në vlerën 33,034 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

Vlera prej 26,534 mijë lekësh përbën detyrim i cili do të shlyhet gjatë vitit 2015.

Emri i objektit 2014	PL 2014	Det 2013	Total 2014	Likuidimi 2014	Diferenca	Det 2014
Mbikqyrje I sist asfa rrugë ne blloqet e pallateve Lagjia 15/1shtesa		59,000	59,000	59,000	0	
Mbikqyrje Punimesh sheshi para Katedrales		445,776	445,776	445,776	0	
Rikonstrukcion Bulevardi I Shengjergjit (Blerje pllakash)		14,086,896	14,086,896	8,500,000	5,586,896	5,586,896
Rikonstrukcion Sheshi para Katedrales		42,593,401	42,593,401	24,029,147	18,564,254	18,564,254
Mbikqyrje Punimesh ndërtim"Sheshi para Teatrit"	2,760,000		2,760,000		2,760,000	907,200
Mbikqyrje Punimesh "Rimodelim Parku Rinia"	1,981,383		1,981,383		1,981,383	787,200
Kolaudim Punimesh "Rimodelim Parku Rinia	370,000		370,000		370,000	370,000
Mbikqyrje Punimesh obj rikonstr I rrugëve ne Lagj nr 6 (rrg Asim Vokshi)	97,181		97,181		97,181	9,000
Kolaudim Punimesh obj rikonstr I rrugëve ne Lagj nr 6 (rrg Asim Vokshi)	19,436		19,436		19,436	19,436
Kolaudim Punimesh ndërtim"Sheshi para Teatrit"	290,000		290,000		290,000	290,000
Total infrastruktura rrugore	5,518,000	57,185,073	62,703,073	33,033,923	29,669,150	26,533,986

Investime në paisje

Fondi i planifikuar për vitin 2014 për blerje paisje ka qënë në vlerën 4,343 mijë lekë nga të cilat 343 mijë lekë ka qënë detyrim nga viti 2013 dhe realizimi në vlerën 2,940 mijë lekë ose 67.7%. Vlera prej 96 mijë lekësh është detyrim i vitit 2014. Detajimi jepet si më poshtë:

